# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria –Vlada-Government***

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo



# Raport i punës për vitin 2015 -SHSKUK

Përgatitur nga:
Zyra e Drejtorit-SHSKUK

Datë: 29.01.2016

**Falënderim:**

Zyra e Drejtorit të SHSKUK-së, falënderon të gjithë drejtorët e klinikave, Spitaleve të Përgjithshme si dhe drejtorët tjerë të njësive organizative të SHSKUK-së, të cilët kanë dërguar raportet e tyre në kohë dhe kanë qenë të involvuar në punë gjatë gjithë kësaj kohe. Falënderim për kolegët tjerë të cilët kanë kontribuar për përgatitjen e këtij raporti të punës.

**Vërejtje:** Në këtë raport nuk janë përfshirë informatat nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, e cila nuk është në menaxhim të SHSKUK-së.

# Përmbajtja

Lista e Shkurtesave/Figurave/Tabelave....................................................................................4
Fjala hyrse e Kryesuesit të Bordit.......................................................................................................6
Fjala hyrse e Drejtorit të Përgjithshëm................................................................................................8
1. Përmbledhja Ekzekutive....................................................................................................10
2. Shërbimet e përgjithshme në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar te Kosovës................13
3. Shërbimet e ofruara ne Qendrën Klinike Universitare te Kosovës.....................................17
3.1. Shërbimet e Klinikave kirurgjike në QKUK...........................................................................21
4. Shërbime tjera të ofruara në SHSKUK- 2015...........................................................................22
4.1. Kardiologjia-QKUK 2015......................................................................................................22
4.2. Statistika-Shërbimet Radiologjike SHSKUK - 2015.................................................................23
4.3. Realizimi i dializave SHSKUK - 2015.....................................................................................24
4.4.Numri i lindjeve SHSKUK 2015...............................................................................................25
4.5. Shërbimet e Klinikës së Onkologjisë QKUK-2015..................................................................26
5. Shërbimet e Spitaleve të Përgjithshme ......................................................................................27
5.1. Shërbimet e veçanta nga Spitalet e Përgjithshme ....................................................................28
6. Shërbimet e ofruara nga Qendra Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK-2015)......................................................................................................................................31
7. Shërbimet e ofruara nga Qendrat Profesionale të Shëndeti Mendor....................................33
8. Programet tjera të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.................................34
8.1. Shërbimet e ofruara nga Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës.................................34
8.2. Qendra Kombëtare e Telemjekësisë së Kosovës............................................................36
8.3. Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive të Kosovës.......................................................36
9. Sektori i Financave SHSKUK...................................................................................................37
10. Donacionet QKUK.................................................................................................................39
11. Barnatorja Qendrore...............................................................................................................40
12.Sektori i Informimit.................................................................................................................42
13. Edukimi i vazdhueshëm..........................................................................................................42
Lista e Referencave......................................................................................................................44

## Lista e Shkurtesave

| | |
|---|---|
| **SHSKUK** | Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës |
| **MSH** | Ministria e Shëndetësisë |
| **BD** | Bordi Drejtues |
| **MF** | Ministria e Financave |
| **QKUK** | Qendra Klinike Universitare e Kosovës |
| **QKUSK** | Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës |
| **QKMP** | Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive |
| **QKMS** | Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive |
| **QKTGJ** | Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut |
| **QKT** | Qendra Kombëtare e Telemjekësisë |
| **SP** | Spitali i Përgjithshëm |
| **QSHMK** | Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi |
| **QIRSK** | Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik |
| **BQ** | Barnatorja Qëndrore |

## Lista e Figurave

Figurë 1: Struktura kualifikuese SHSKUK
Figure 2: Struktura Gjinore në SHSKUK
Figurë 3 : Shërbimet e SHSKUK - 2015
Figurë 4: Totali i shërbimeve SHSKUK-2015
Figurë 5: Struktura kualifikuese QKUK
Figure 6: Institutet Paraklinike QKUK
Figure 7: Totali i Shërbimeve QKUK-2015
Figure 8:Raportet e Punës 2015 –Klinikat Kirurgjike
Figure 9:Statistikat me rëndësi –Kardiologji -2015
Figurë 10: Raport i punës për shërbimet radiologjike SHSKUK – 2015
Figurë11: Shërbimet e klinikës së onkologjisë QKUK-2015
Figurë 12:Struktura kualifikuese –Spitalet e Përgjithshme
Figurë 13: Ditë shërimi –Spitalet e Përgjithshme
Figure 14: Numri i të shtrirëve –Spitalet e Përgjithshme - 2015
Figure 15: Numri i te Operuarve ne Spitalet Rajonale- 2015
Figure 16: Vizitat Ambulantore -Spitalet e Përgjithshme- 2015
Figure 17:Shërbimet Laboratorike Spitalet e Përgjithshme - 2015

Figurë 18: Shërbimet tjera/Diagnostike
Figure 19: Struktura kualifikuese QSKUK
Figurë 20: Shërbimet e ofruara QSKUK
Figurë 21: Struktura kualifikuese QSHM
Figurë 22: Shërbimi i Shëndetit Profesional Mendor i tërë Kosovës
Figurë 23: Struktura kualifikuese e programeve tjera të SHSKUK-së
Figure 24: Raport i Punës - 2015- Mjekësia e Punës Gjakovë
Figure 25: Numri i vizitave ne QTK 2015
Figure 26: Numri i vizitave në bibloteke elektronike
Figure 27: Realizimi i buxhetit SHSKUK- 2015
Figurë 28: Realizimi i buxhetit 2015
Figure 29 : Përqindja e furnizimit të Barnatores Qëndrore të QKUK-së.
Figurë 30:Përqindjet e furnizimit nga Lista Esenciale për Barna dhe Materdial medicinal nga Spitalet e Përgjithsme
Figurë 31: Furnzimi I Spitaleve të Përgjitshme-SHSKUK 2015

## Lista e Tabelave

Tabela 1: Total Shërbimet SHSKUK- 2015
Tabela 2: Krahasimi i shërbimeve të njësive përbërsë të SHSKUK-së
Tabela 3: Shërbimet laboratorike të njësive përbërse të SHSKUK-së
Tabela 4: Totali Shërbimet e QKUK-se
Tabela 5: Shërbimet e Instituteve Paraklinike
Tabela 6: Shërbimi nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike
Tabela 7 : Totali Shërbimet e QKUK-se
Tabela 8: Shërbimet laboratorike QKUK
Tabela 9: Raportet e Punës–Klinikat Kirurgjike
Tabela 10: Shërbimet e Klinikës Kardiologjike-QKUK
Tabela 11: Shërbimet Radiologjike SHSKUK- 2015
Tabela 12: Shërbimet e Klinikës Radiologjike QKUK
Tabela 13: Numri i dializave SHSKUK - 2015
Tabela 14: Numri i lindjeve SHSKUK – 2015
Tabela 15: Krahasimi i lindjeve të njësive përbërse të SHSKUK-së
Tabela 16: Shërbimet e Spitaleve të përgjithshme
Tabela 17: Krahasimet e shërbimeve të spitaleve të përgjithshme-SHSKUK
Tabelë 18: Shërbimet e ofruara QSKUK dhe krahasimet
Tabela 19: Shërbimet e Shëndetit Mendor te Kosovës
Tabela 20: Raporti i punës -2015- Mjekësia e Punës Gjakovë
Tabela 21 : Kontrolle mjekësore sistematike për sportistë
Tabela 22: Realizimi i Buxhetit SHSKUK -2015

## Fjala e Kryesuesit të Bordit të SHSKUK-së

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës dhe Bordi Drejtues janë produkte të Ligjit për Shëndetësi (Nr. 04/L-125). SHSKUK-ja është themeluar me hyrjen në fuqi të Statutit të SHSKUK-së me datë 11.11.2013. Vendimi ( Nr.10/168, Datë: 29.01.2014) i Kryeministrit të Republikës së Kosovës e themelon Bordin Drejtues të SHSKUK-së në përbërje prej shtatë anëtarëve: Një anëtar nga QKUK-ja, një anëtar nga QSKUK-ja, një anëtar nga IKSHP-ja, një anëtar nga Spitalet Rajonale të Kosovës, një anëtar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës ( Niveli Parësor Shëndetësor ), një anëtar nga MSH-ja, dhe një anëtar që zgjedhet nga konkursi publikë në pozitën e Drejtorit Financiar.

- ANËTARËT E BORDIT DREJTUES : 1) **Dr Sadik Llullaku - Kryesues.** Përfaqësues nga QKUK-ja. I emëruar si Kryesues i Bordit Drejtues në mbledhjen e 5 (pestë), datë: 18.02.2015, të Bordit Drejtues. 2) **Dr Shemsi Veseli – Anëtar.** Përfaqësues nga MSH. 3) **Prof.Dr. Metush Disha – Anëtar.** Përfaqësues nga QKSUK. 4) **Dr Besim Iliazi – Anëtar**. Përfaqësues nga Asociacioni i Komunave. 5) **Dr Bleta Domi – Anëtare.** Përfaqësues nga Spitalet Regjionale. I vazhdohet mandati, sipas Shkresës së Zyrës Ligjore të Kryeministrit, si anëtare e Bordit Drejtues me Vendimin Nr.Prot:739,Datë: 30.4.2015. 6) **Z. Myzafer Kalanderi – Anëtar.** Drejtor Financiar i BD të SHSKUK i përzgjedhur nga konkursi publikë, ka filluar punën me datë 01.06.2014. Ka marr pjesë në 8 mbledhje të Bordit Drejtues në vitin 2015. Për shkak të Vendimit te Inspektoratit te Punës është larguar nga pozita e Anëtarit të Bordit Drejtues-Drejtorit Financiar të BD-se sipas Vendimit te Bordit Drejtues Nr.Prot:529, Datë:27.03.2015.

SHSKUK përbëhet nga Institucione Shëndetësore të Nivelit Dytësorë dhe Tretësorë ( Qendra Klinike Universitare, Qendra Klinike Universitare Stomatologjike, Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë, Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive, Qendra Kombëtare e Telemjekësisë, Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë, Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, Spitali i Përgjithshëm në Pejë, Spitali i Përgjithshëm në Gjakove, Spitali i Përgjithshëm në Prizren, Spitali i Përgjithshëm ne Ferizaj, Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri) si Njësi Organizative të SHSKUK-së ) dhe nga Shërbimet Profesionale si Njësi të tij administrative dhe funksionale, në pajtim me Ligjin për Shëndetësi.

- MBLEDHJET E BORDIT DREJTUES - Gjatë periudhës kohore janar-dhjetor 2015, Bordi Drejtues i SHSKUK-së ka realizuar 25 mbledhje ( në të cilat, në rolin e vëzhguesit, kanë marrë pjesë edhe Këshilltarët e Ministrit, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, Zyrtari Kryesor Financiar i SHSKUK-së, Përfaqësuesi nga Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë “ PRAK”, Përfaqësuesi i FSSHK-së si dhe vëzhguese të tjerë për tema të caktuara) në të cilat ka trajtuar tema si: Buxheti i SHSKUK-së, Projekti i Emergjencës, Raporti i Punës së SHSKUK-së për vitin 2014, Miratimi i Raportit të Punës së SHSKUK-së për periudhën kohore janar-mars 2015, Miratimi I Raportit të Punës së SHSKUK-së për periudhën kohore janar-qershor 2015,

Miratimi i Raportit të Punës së SHSKUK-së për periudhën kohore janar -shtator 2015, Miratimi i kontratave për furnizim me barna dhe material medicinal, Gjendja e furnizimit me barna dhe material harxhues në SHSKUK, Çështja e kujdestarive në Spitalin e Mitrovicës, Raporte nga Drejtori i Përgjithshëm për gjendjen në SHKUK, Miratimi i Planit afatmesëm i punës së

SHSKUK-së 2015-2017, Miratimi i Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Auditorit të Përgjithshëm, Miratimi i Raporteve Finale të Njësisë së Auditimit të Brendshëm të SHSKUK-së, Miratimi i Planit strategjik të punës për Njësinë e Auditimit të Brendshëm të SHSKUK-së, për periudhën 01.01.2016-2018, Miratimi i Planit të veprimit për Barna dhe Material medicional për vitin 2015,Miratimi i Raportit të Punës se Bordit Drejtues për vitin 2014, Miratimi i Raportit të Punës së Bordit Drejtues për periudhën kohore janar-mars 2015, Miratimi i Raportit të Punës së Bordit Drejtues për periudhën kohore janar-qershor 2015, Miratimi i Planit të Veprimit për Barna dhe Material medicinal-shpenzues dhe Citostatik të Listës Esenciale për v.2016, QKUK-SHSKUK. Miratimi i Rregulloreve të ndryshme për Njësit Organizative të SHSKUK-së, Shqyrtimi i Organogramëve të Njësive Organizative të SHSKUK-së, Miratimi i Planit të veprimit për barna dhe material harxhues për vitin 2016, Miratimi-shqyrtimi i kërkesave të ndryshme nga Njësit Organizative të SHSKUK-së etj.
Në funksion të mbarëvajtjes së punës në SHSKUK, Bordi Drejtues në këtë periudhë kohore ka marr 178 vendime.

- Bordi Drejtues ka ndihmuar në : menaxhim më efikas të Njësive Organizative të SHSKUK-së, menaxhim më efikas të buxhetit të SHSKUK-së, komunikim më produktiv në mes të Njësive Organizative, furnizim më të mirë të barnave dhe materialit medicinal nga Lista Esenciale, komunikim më të mirë me FSSHK dhe Shoqatën për të Drejtat e Pacientëve, përmirësimin e dukshëm të trajtimit të pacienteve në përgjithësi dhe me fokus të veçantë pacientëve onkologjike, fillimin e suksesshëm të punës së shërbimit të kardiologjisë-QKUK, shtimin e procedurave diagnostike dhe terapeutike në Klinikën e Kardiologjisë Invazive - QKUK, zvogëlimin e listës së pritjes së pacientëve për marrjen e shërbimeve të caktuara shëndetësore etj.

- KONKLUZION- Shikuar në dimensionin një vjeçar, ecuria e punës së Bordit Drejtues, me gjithë vështërsit eventuale gjatë rrugës, ka qenë e rëndësishme në avancimin substancial të reformës. Bordi Drejtues i ka dhënë formë reformës së filluar në shëndetësinë e vendit duke pas si qëllim imediat pacientin në fokus.

Objektivi kryesor për vitin 2016 mbetet furnizimi 100% me barna dhe material medicnal nga Lista Esenciale.

**Dr Sadik Llullaku, MD, PhD**

**Kryesues i Bordit Drejtues të SHSKUK**

## Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm

Shëndetësia e Kosovës gjatë vitit 2015 shënoi një normë pozitive të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, përderisa vazhdoi të reflektojë nivel të kënaqshëm të ofrimit të shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës gjatë këtij viti u bazua në rritjen e furnizimit me barëra dhe material medicinal, si dhe një përkushtim i stafit të përgjithshëm medicinal në kuadër të SHSKUK-së. Shëndetësia kosovare kishte një nivel të ulët të buxhetit, edhe përkundër këtyre mungesave institucionet shëndetësore nën varësi të SHSKUK-së vazhduan të ruajnë nivelin e lartë të ofrimit të shërbimeve shëndetësore. Kjo, mes tjerash, paraqet punën e suksesshme të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (SHSKUK) në përmbushjen e objektivave të saj që dalin nga Ligji për Shëndetësi dhe legjislacioni tjetër në fuqi. Është punuar në drejtim të shtimit të stafit shëndetësorë, po ashtu investime në kuadër për Spitalin e Përgjithshëm në Mitrovicë, i cili ka pasur mungesë enorme të kirurgëve dhe stafit tjetër përcjellës.

Gjatë vitit 2015, në gjithsej 56 institucione shëndetësore te kujdesit dytësor dhe tretësor të cilat janë nën varësi të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (SHSKUK), janë ofruar një numër i konsiderueshëm i shërbimeve shëndetësore për pacientët në të gjitha njësitë përbërëse. Gjatë këtij viti janë regjistruar gjithsej 877 266 ditë shërimi(mjekimi) për 160 793 pacient të shtrirë, nga këta pacientë janë kryer gjithsej 39 522 operime.

Furnizimi me produkte medicinale ishte shumë më i mirë në vitin 2015, krahasuar me vitin 2014 në barna nga Lista Esenciale(LE) dhe materialit shpenzues nga Lista Esenciale (LE). QKUK-ja, ka arritur të ketë furnizim në barna nga LE me 74.60%, material shpenzues nga LE furnizimi ishte 68% si dhe citostatikët nga LE me 92%. Spitalet e Përgjithshme furnizim me barna nga LE ishte 84.42% dhe material shpenzues nga LE me 81.02%. Si dhe furnizim i kënaqshëm ishte me barna dhe material shpenzues nga LE në Qendrat Profesionale të Shëndetit Mendor të Kosovës me 89%. Një ndihmesë shumë e madhe përveç buxhetit të shtetit ishte edhe nga donatorët të ndryshëm, të cilët kanë dhuruar donacion në barna dhe material shpenzues në vlerë prej 4,334,057.34 euro.

Njëra edhe ndër sukseset e Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës ishte dhe shfrytëzimi i buxhetit. SHSKUK, gjatë vitit 2015 kishte buxhet prej 87,501,839.00 euro në të gjitha kategoritë buxhetore. Shfrytëzimi i buxhetit ishte 99% apo 86,591,759.49 euro, me një mbetje të pa shfrytëzuar prej 821,367.00 euro të cilat kanë mbetur në suficit.

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës gjatë vitit 2015 ishte mjaft active në zhvillimin mëtejmë të institucioneve shëndetësore, janë hartuar rregullore të brendshme për çështje të ndryshme në nivel të SHSKUK-së, nga grupet profesionale. Janë krijuar plane veprimi për zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve nga Institucione të pavarura sipas detyrë zyrtare. Janë formuar grupe punuese të cilët kanë bërë përmbledhjen e të gjitha kërkesave për investime

kapitale si aparatura, renovime dhe ndërtime të objekteve. Janë kryer vizita sistematike për të gjithë të punësuarit e QKUK-së, të cilët janë mbikëqyrur nga sektori për siguri dhe shëndet në punë, sektor i cili ka pasur mbështetje të Qendrës Kombëtarë të Mjeksisë së Punës në Gjakovë.

Kemi punuar në Funksionalizimin e aparaturave të domosdoshme për kryerjen e ekzaminimeve të ndryshme diagnostike, përfshirë aparaturat radiologjike, ato biokimike, por edhe aparaturat tjera dignostike që kanë klinikat e QKUK-së, Spitalet e Përgjithshme, Qendrat Profesionale të Shëndetit Mendor, por edhe në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë dhe Mjekësisë Sportive në Prishtinë, Qendrën Kombëtare të Telemjekësisë dhe njësitë tjera.

Sifdë kryesore mbetet buxheti i limituar për pajisje mjekësore. Janë identifikuar nevojat reale të të gjitha njësive përbërse të ShSKUK-së, të cilat arrijnë një vlerë prej rreth 40 milion euro, ndërsa buxheti i ndarë për këtë kategori është shumfish më i vogël. Këto probleme buxhetore paraqesin një ndër sfidat kryesore për ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Përkundër këtyre sfidave buxheotre një ndihmesë të madhe janë duke e dhënë donator të ndryshëm si në ndërtim, pajisje dhe renovime të ndryshme. Janë dhuruar donacione të shumta, vlera e përafërt e donacioneve të përfituara gjatë vitit 2015 ishte 4.7 milion euro si dhe janë duke u kryer investime në ndërtime: është duke u rindërtuar Spitali i Vushtrrisë. Spitali i Mitrovicës ka përfituar donacione në rindërtim të reparteve. Janë duke u kryer investime në projekte të efiqiencës së rrymës (fasadime të objekteve të QKUK-së).Është nënshkruar një memorandum për investim për Klinkën e Kirurgjisë së Femijëve dhe Klinikën Pediatrike në QKUK në vlerë financiare prej 22 milion euro.

**Curr Gjocaj**

**Drejtor i Përgjithshëm**

**Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës**

# 1. Përmbledhja Ekzekutive

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) ka përmbyllur vitin 2015 me numër të konsiderueshëm të shërbimeve shëndetësore të kryera për pacientët në të gjitha njësitë përbërëse. Për vitin 2015 ne kuadër të SHSKUK-së, janë kryer 39 522 operacione të ndryshme, me 160 793 pacientë të shtrirë me 877 266 ditë mjekimi.

Gjatë vitit 2015, në Qendrën Klinike Universitare kanë qenë 492 853 ditë shërimi, me 74 587 pacientë të shtrirë, nga këta pacientë të shtrirë 21 671 janë operuar. Gjatë vitit 2015 ishin 371 101 vizita ambulatore për pacientë dhe 851 321 ishin shërbime të veçanta apo diagnostike, ndërsa shërbime (parametra) laboratorike ishin 1 054 397 për 309 161 pacientë. Numri i lindjeve ishte 9641 gjatë gjithë vitit 2015, numri i dializave ishte 34 224. Gjatësia e shërimit për pacient 6.6 ditë.

Në shtatë Spitalet e Përgjithshme të Kosovës, Mitrovicë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Vushtrri, Prizren dhe Pejë, kanë qenë të shtrirë 86 206 pacientë me 384 413 ditë shërimi, me 17 851 operacione, ndërsa janë kryer 1 322 543 shërbime laboratorike për 130 970 pacientë.

Shëndeti Profesional Mendor me 8 njësi në të gjithë Kosovën, ka regjistruar 97 410 vizita ambulatore dhe qëndrime ditore, ndërsa ka regjistruar 87 415 shërbime tjera të veçanta.

Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë gjatë viti 2015, regjistron 27 555 vizita ambulatore, me 108 375 shërbime laboratorike për 7616 pacientë dhe 39 404 shërbime të veçanta.

QKSUK-ja, gjithsej ka kryer 55 657 vizita të para, ose vizita kontrolluese. Shërbime tjera të veçanta ne QSKUK si shërbimet specifike të tyre janë kryer 276 279 shërbime.

QKMS-ja, gjatë nëntë muajve të parë ka kryer 16 171 shërbime specialistike.

Qendra kombëtare e Telemjekësisë - ka kryer gjithsej 5904 shërbime.

Furnizimi me produkte medicniale gjatë vitit 2015, ka qenë shumë më i mirë krahasuar me vitin 2014. Edhe përkundër shkurtimeve buxhetore është arritur të kemi furnizim shumë më të mirë. Furnizimi nga Lista Esenciale në QKUK gjatë vitit 2015 ishte 74.60% , krahasuar me vitin 2014, kemi rritje prej 33% në furnizim të barnave nga Lista Esenciale. Në kategorinë e materialit medicinal nga Lista Esenciale, në vitin 2015 kishim një furnizim prej 68%, ndërsa në vitin 2014 kishte furniim prej 37.20%. Furnizimi me citostatikë nga Lista Esenciale gjatë vitit 2015 ishte një furnizim prej 92%, krahasuar me vitin 2014 ku kishim 43% furnizim, diferenca është një rritje në furnizim me citostatikë nga Lista Esencial me 49%.

Spitalet e Përgjithshme në kategorinë e furnizimit me barna nga Lista e Esencial kishin një furnizim prej 84.42% , krahasuar me vitin 2014 ku furnizimi ishte 59.34% që i bie një rritje prej

25.08% në furnizim. Furnizmi me material medicianl nga Lista Esenciale në vitin 2015 ishte 81.02% , krahasuar me vitin 2014 ku kishim një furnizim prej 63.48% nga lista esenciale për Spitalet e Përgjithshme.

Furnizimi në 8 njësi të Qendrave Profesionale të Shëndetit Mendor të Kosovës, gjatë vitit 2015 ishte 89% nga Lista Esenciale. Në vitin 2014 ishte një furnizim më i ulët se 50%.

**Shërbimet e veçanta-**

**Klinika e Kardiologjisë** - Gjatë vitit 2015 janë realizuar gjithsej 1717 ergometri, 5984 ekokardiografi, 159 transezofagale, 1176 koronarografi, 462 stente, 85 pace-maker të përhershëm, 20 ICD, 17075 EKG, 5CRT dhe 106 dilatim të arterieve koronare.

Klinika e Kardiologjisë së QKUK-së, ka një rritje të ofrimit të shërbimeve sa i përket specifikave të saj, kjo pothuajse në të gjitha shërbimet. Janë ofruar 41.54% më shumë ergometri krahasuar me vitin 2014 apo të shprehur në diferencë me 504 më shumë. Ekokardiografi gjatë vitit ishin 5984, apo 638 më shumë se në vitin 2014. Gjithashtu rritje prej 17.6% janë realizuar në koronarografi, apo 176 më shumë. Gjatë vitit 2015 kishim rritje prej 55.55% të ofrimit të stentave me gjithsej 462 apo 176 më shumë se në vitin 2014.

**Shërbimet Radiologjike** Në nivel vendi, gjatë periudhës së vitit 2015, janë realizuar gjithsej 29 446 CT, 55 243 ultrazë, 243 165 radiografi, 6312 MRI.

Spitalet e Përgjithshme kanë kryer një numër të konsiderueshme të shërbimeve radiologjike, Spitali i Prizrenit ka kryer 3344 CT,7164 ultrazë , 24157 radiografi. Spitali i Pejës ka kryer 3833 CT, 11029 ultrazë, 23644 radiografi.

Nga statistika e sjellë nga Klinika e Radiologjisë në QKUK rezulton se janë kryer 158940 radiografi, shërbimet me ultrazë gjithsej 16895 për pacientë. Janë kryer 29 446 tomografi të kompjuterizuara (CT) dhe 6312 Rezonanca Magnetike(MRI).

**Hemodializa-** Gjatë vitit 2015, në njësitë përbërse të SHSKUK-së janë realizuar gjithsej 109 005 dializa. Gjatë kësaj periudhe në QKUK janë kryer 34 224 dializa apo 31% e gjithsej dializave. Spitali i Prizrenit ka realizuar 26 426 dializa apo 24% e totalit.

**Lindjet**- Total numri i lindjeve i periudhës së vitit 2015 është 22804, ku 6218 lindje janë kryer me operacion, ndërsa numri i të lindurve është 23025.

Numri i lindjeve gjatë vitit 2015 ka rënë me 6.5% apo me 1586 lindje më pak krahasuar me vitin 2014. Vetëm Spitali i Përgjithshëm i Mitrovicës ka shënuar rritje sa i përket numrit të lindjeve me 25% apo 322 lindje më shumë se në vitin 2014. Spitali i Vushtrrisë ka një rënie më të madhe, pasi ky spital është i mbyllur përkohësisht sepse është duke u rinovuar. Shumë nga këto

shërbime kryhen në Spitalin e Përgjithshëm të Mitrovicës. QKUK,  ka shënuar rënie me 6.5% të numrit të lindjeve apo me 666 lindje më pak se në vitin 2014.

Në total SHSKUK- ka pranuar donacion në vlerë rreth **4,793,707.34** euro (barna,paisje mjekësore dhe inventarë të ndryshëm) në të gjitha njësitë e saja, po janë edhe disa donacione të cilat nuk janë deklaruar me vlerë financiare.

Total buxheti i të gjitha njësive përbërse të SHSKUK-së ishte 87,501,839.00 euro në të gjitha kategoritë buxhetore. Shfrytëzimi i buxhetit ishte 99% apo 86,591,759.49 euro janë shpenzuar gjatë tërë vitit 2015. Vetëm 821,367.00  kanë mbetur pa u shpenzuar (shfrytëzuar).

## 2. Shërbimet e përgjithshme në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar te Kosovës

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës në sistemin e pagave ka të regjistruar 6711 punëtorë. Mjekë specialistë janë 21% e stafit, infermier/e janë 62% dhe 16% e stafit është staf jo- mjekësor.

Të shprehur në numra, 1 410 janë mjekë specialistë, 4 215 të punëtorëve janë infermier/e dhe 1086 janë kuadër tjetër jo-mjekësor.




*Figurë 1: Struktura kualifikuese SHSKUK*




*Figure 2: Struktura Gjinore në SHSKUK*

| Struktura gjinore në SHSKUK | | |
|---|---|---|
| Femra | Meshkuj | Totali |
| 4363 | 2348 | 6711 |

Gjithsej të punësuar në SHSKUK janë 6711 punonjës, 4363 i përkasin gjinisë femërore dhe 2348 janë meshkuj.

Aktivitetet e punës në Shërbimin Spitalor Klinik Universtar të Kosovës:




| | Ditë shërimi | Nr. të shtrirëve | Nr.të operuarve | Vizita ambulantore/qendrime ditore SHM | Shërbime laboratorike | Shërbime tjera/apo te vecanta (diagnostike) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| QKUK | 492853 | 74587 | 21671 | 371101 | 1054397 | 851321 |
| Spitalet | 384413 | 86206 | 17851 | 702626 | 1322543 | 598924 |
| Shendeti Mendor | | | | 97410 | | 87415 |
| Mjeksia e Punes | | | | 27555 | 108375 | 39404 |
| QSKUK | | | | 55657 | | 276279 |
| QKMS | | | | 16171 | | |
| Telemjekësia | | | | | | 5904 |

*Figurë 3 : Shërbimet e SHSKUK - 2015*

Gjatë vitit 2015, në Qendrën Klinike Universitare kanë qenë 492 853 ditë shërimi, me 74 587 pacientë të shtrirë, ku nga këta pacientë të shtrirë 21 671 pacientë janë operuar. Gjatë vitit 2015 ishin 371 101 vizita ambulantore për pacientë dhe 851 321 ishin shërbime të veçanta apo diagnostike, ndërsa shërbime (parametra) laboratorike ishin 1 054 397 për 309 161 .

Në 7 Spitalet e Përgjithshme kishte 384 413 ditë shërimi, me 86 206 pacientë të shtrirë, ku 17 851 pacientë janë operuar. Gjithsej vizita ambulantore ishin 702 626, ndërsa shërbime (parametra) laboratorike ishin 1 322 543 për 130 970 pacientë, shërbime tjera apo të veçanta (diagnostike) ishin 598 924.

Në Qendrat Profesionale të Shëndeti Mendor me 8 njësi në të gjithë Kosovën kishte 87 415 vizita për terapi okupuese dhe shërbime tjera me 97 410 vizita ambulatore.

Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë për vitin 2015, regjistron 27555 vizita ambulantore, me 108 375(parametra) shërbime laboratorike për 7616 pacientë dhe 39 404 shërbime të veçanta.

QKSUK-ja, gjithsej ka kryer 55 657 vizita të para ose vizita kontrolluese. Shërbime tjera të veçanta ne QSKUK si shërbimet specifike të tyre janë kryer 276 279.

QKMS-ja, gjatë nëntë muajve të parë ka kryer 16 171 shërbime specialistike, dhe QKT (telemjekësia) ka kryer 5904 shërbime.

| Total Shërbimet SHSKUK- 2015 | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Klinika/ Spitalet | Nr i shtretërve | Ditë shërimi | Nr. të shtrirëve | Nr.të operuarve | Vizita ambulantore/q endrime ditore SHM | Shërbime laboratorike | Shërbime tjera/apo te vecanta (diagnostike) | Nr i lindjeve | Nr i dializave | Mesatarja ditore e shërimit |
| **QKUK** | 37 | 2039 | 492853 | 74587 | 21671 | 371101 | 1054397 | 851321 | 9641 | 34224 | 6.60 |
| **Spitalet** | 7 | 2004 | 384413 | 86206 | 17851 | 702626 | 1322543 | 598924 | 13163 | 74781 | 4.45 |
| **Shendeti Mendor** | 8 | 154 | | | | 97410 | | 87415 | | | |
| **Mjeksia e Punes** | 1 | | | | | 27555 | 108375 | 39404 | | | |
| **QSKUK** | 1 | | | | | 55657 | | 276279 | | | |
| **QKMS** | 1 | | | | | 16171 | | | | | |
| **Telemjekësia** | 1 | | | | | | | 5904 | | | |
| **Totali** | **56** | **4197** | **877266** | **160793** | **39522** | **1270520** | **2485315** | **1859247** | **22804** | **109005** | **5.45** |

*Tabela 1: Total Shërbimet SHSKUK- 2015*

Në SHSKUK gjatë vitit 2015, ishin **6 575 059** shërbime, ku 877 266 të shërbimeve ishin **ditë shërimi** në nivel të Kosovës me 160 793 **pacientë të shtrirë**. Bazuar në raportet e pranuara të cilat janë të paraqitura në tabelën 1, rezulton që **39 522** operime janë kryer në nivel të SHSKUK-së. Ndërsa shërbime (parametra) laboratorike janë **2 485 315** për **447 747** pacientë.




*Figurë 4: Totali i shërbimeve SHSKUK-2015*

Gjatë vitit 2015, nga të gjitha shërbimet mjekësore në SHSKUK, 1% apo 39 522 janë operime, 22% nga shërbimet janë shërbime ambulanotre, 44% e parametra laboratorike dhe 33% nga total shërbimet mjekësore janë shërbime tjera/diagnostike apo të veçanta.

| | Ditë shërimi | Nr. të shtrirëve | Shfrytëzimi i kapaciteteve | Gjatësia e Shërimit | Numri i Shtretërve |
|---|---|---|---|---|---|
| **QKUK** | 492853 | 74587 | 65.74 | 6.60 | 2030 |
| **Spitalet** | 384413 | 86206 | 53.35 | 4.45 | 1974 |
| **Gjithsej** | **877266** | **160793** | **60.03** | **5.45** | **4004** |

Tabela 2: Krahasimi i shërbimeve të njësive përbërsë të SHSKUK-së.

Gjatësia mesatare shërimit gjatë vitit 2015 në SHSKUK është 5.4 ditë për pacientë të shtrirë. Në QKUK 6.6 ditë shërimi mesatar për pacientë, ndërsa në Spitalet e Përgjithshme 4.45 ditë shërimi për pacientë. Shfrytëzimi i kapaciteteve është 60.03%. QKUK ka shfryetzueshmërinë e kapaciteteve me 65.74% , ndërsa spitalet e përgjithshme kanë shfytzueshmërinë me 53.35%.

| **Shërbimet laboratorike** | | | |
|---|---|---|---|
| **Emri i Institucionit** | Nr i pacientëve | Analizat e realizuara | % e analizave të realizuar |
| **Spitali Vushtrri** | 1434 | 5515 | 0% |
| **Spitali Gjakovë** | 20987 | 241788 | 10% |
| **Spitali Mitrovicë** | 15224 | 62783 | 3% |
| **Spitali Ferizaj** | 16291 | 63619 | 3% |
| **Spitali Gjilan** | 26712 | 190253 | 8% |
| **Spitali Prizren** | 31610 | 406235 | 16% |
| **Spitali Pejë** | 18712 | 353001 | 14% |
| **QKUK** | 309161 | 1054397 | 42% |
| **Mjekësia e Punës Gjakovë** | 7616 | 108375 | 4% |
| **Totali** | **447747** | **2485966** | |

*Tabela 3: Shërbimet laboratorike të njësive përbërse të SHSKUK-së*

## 3. Shërbimet e ofruara në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës- QKUK

Në QKUK, 37 klinika, institute dhe shërbime ofrojnë shërbime shëndetësore të ndryshme varësisht nga specifikat e tyre.

QKUK në listën e pagave ka gjithsej 3029 punëtorë, 1855 punëtor i përkasin sektorit infermirisë,625 punëtore i përkasin sektorit të mjekëve specialistë dhe 549 punëtorë i përkasin stafit jo-mjekësor.




*Figurë 5: Struktura kualifikuese QKUK*

Shërbimet shëndetësore të ofruara gjatë vitit 2015 do të pasqyrohen si në tabelën në vijim:

| Nr | QKUK | Nr i Shtretërve | Ditë shërimi | Nr. të shtrirëve | Nr.të operuarve | Vizita ambulantore | Vizita tjera diagnostike | Shërbime laboratorike | Shërbime e tjera/apo te veçanta | Shfr i kapaciteteve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Klinika Obstetrike Gjinekologjike | 399 | 84042 | 17036 | 4262 | 3154 | 14396 | | 67286 | 57.70 |
| 2 | Klinika e Dermatovenerologjisë | 36 | 9648 | 925 | 21 | 16186 | 5172 | | 9048 | 73.42 |
| 3 | Kirurgjia Abdominale | 70 | 18494 | 3061 | 2171 | 3737 | 1871 | | 8447 | 72.38 |
| 4 | Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale | 32 | 7623 | 818 | 1123 | 10194 | 125 | | 11110 | 65.26 |
| 5 | Klinika Ortopedisë dhe Traumatologjisë | 104 | 22668 | 2562 | 2017 | 17091 | 3838 | | 15191 | 59.71 |
| 6 | Klinika e Kirurgjisë Torakale | 26 | 7745 | 979 | 634 | 7380 | 61 | | 774 | 81.61 |
| 7 | Klinika e Gastroenterologjisë | 33 | 10820 | 1020 | | 6242 | 9477 | | 5770 | 89.82 |
| 8 | Klinika e Hematologjisë | 31 | 6740 | 540 | | 3433 | | | 7407 | 59.56 |
| 9 | Klinika e Neonotalogjisë | 180 | 46399 | 10416 | 38 | 2643 | 20767 | | | 70.62 |
| 10 | Klinika infektive | 130 | 36843 | 3731 | | 12611 | 12083 | | 8714 | 77.64 |
| 11 | Klinika e Syve | 54 | 10912 | 1636 | 2252 | 36227 | 2457 | | | 55.36 |
| 12 | Klinika e Nefrologjisë | 94 | 5858 | 551 | | 2531 | 1979 | | 34994 | 17.07 |
| 13 | Shërbimi i Ortoprotetikës | | | | | 2694 | | | 2780 | |
| 14 | Klinika e Pulmologjisë | 68 | 22694 | 1647 | | 9839 | 13184 | | | 91.43 |
| 15 | Klinika e Kardiologjisë | 57 | 17959 | 4399 | 0 | 15585 | | | 26789 | 86.32 |
| 16 | Klinika e Pediatrisë | 151 | 50566 | 5907 | | 19074 | 19895 | | 29646 | 91.74 |
| 17 | Klinika e Endrokrinologjisë | 38 | 11612 | 796 | | 6585 | 27700 | | 2261 | 83.72 |
| 18 | Klinika e Anesteziologjisë dhe Reanimacionit | 38 | 11987 | 6065 | | 51533 | | | 17113 | 86.42 |
| 19 | Klinika e ORL-së | 74 | 27307 | 2482 | 2023 | 21055 | 4236 | | 4251 | 101.1 |
| 20 | Klinika e Neurologjisë | 68 | 19127 | 2029 | | 14870 | 7210 | | 2638 | 77.06 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **21** | Klinika e Biokimisë Mjekësore | | | | | | | 1054397 | | |
| **22** | Shërbimi Mjekësi Nukleare | | | | | 241 | 1435 | | | |
| **23** | Shërbimi Klinik Emergjent | 19 | | | 2249 | 49069 | | | | |
| **24** | Klinika e Fiziatrisë | 14 | 3533 | 196 | | 7187 | 4165 | | 62680 | 69.13 |
| **25** | Klinika e Kirurgjisë Plastike | 20 | 5132 | 954 | 846 | 8000 | | | | 70.30 |
| **26** | Klinika e Neurokirurgjisë | 24 | 7651 | 1075 | 522 | 4110 | 1129 | | 1657 | 87.34 |
| **27** | Klinika e Urologjisë | 24 | 6323 | 1216 | 1091 | 6470 | 2085 | | 1029 | 72.18 |
| **28** | Klinika e Onkologjisë | 44 | | | | | | | 119573 | |
| **29** | Klinika e Kardiokirurgjisë | 15 | | | 27 | 170 | | | | |
| **30** | Klinika e Psikiatrisë | 77 | 16543 | 835 | | 11846 | 2230 | | 8305 | 58.86 |
| **31** | Klinika e Radiologjisë | | | | | | | | 219486 | |
| **32** | Klinika e Reumatologjisë | 26 | 7294 | 636 | | 5150 | 73 | | 705 | 76.85 |
| **33** | Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve | 37 | 6013 | 1837 | 1432 | 8024 | 1088 | | 2605 | 44.52 |
| **34** | Klinika Kirurgji Vaskulare | 32 | 7696 | 1215 | 963 | 8030 | 2475 | | 446 | 65.89 |
| | **Total** | **2039** | **489229** | **74564** | **21671** | **370961** | **159131** | **1054397** | **670705** | **65.73** |

*Tabela 4: Totali Shërbimet e QKUK-se*

**Koment:** Tek rezultatet statistikore të Klinikës së Biokimisë Mjekësore figuron numri i analizave të kryera nga pacientët, pra numri nuk paraqet totalin e pacientëve, por analizat e kryera. Numri i pacientëve që kanë kryer shërbime laboratorike është 309161.

| **INSTITUTET PARAKLINIKE** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Anatomia Patologjike** | Totali | Fiziologjia Patologjike | Totali | Alergologji | Totali | Morgu | totali |
| **Biopsi** | 10820 | Kontrolle | 1386 | Tumor marker | | Pranime | 461 |
| **Citologji** | 615 | Spirometri | 1386 | Kontrolle | 2164 | Lëshime | 412 |
| **Pap-test** | 1673 | Inhalime | 94 | Teste alergjike | 258 | Mbetje | 2 |
| **Intraoperative** | 85 | | | Vaksina | 274 | Amputime | 62 |
| **HC** | 152 | | | | | | |
| **IHC** | 1145 | | | | | | |
| **Autopsi** | 17 | | | | | | |
| **Totali** | 14507 | | 2866 | | 2696 | | 937 |

*Tabela 5: Shërbimet e Instituteve Paraklinike*




*Figure 6: Institutet Paraklinike QKUK*

| Instituti i Psikiatrisë Forenzike | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Repartet** | Ditë shërimi | Nr. të shtrirëve | Vizita ambulantore | Vizita tjera diagnostike |
| **3** | 3624 | 87 | 140 | 479 |

*Tabela 6: Shërbimi nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike*

Gjatë vitit 2015 Instituti i Psikiatrisë Forenzike ka pasur 64 të shtrirë me 3624 ditë shërimi me 140 vizita ambulantore dhe me 479 shërbime tjera diagnostike.

**Total shërbimet në QKUK** do të pasqyrohen në tabelën në vijim:

| Totali i shërbimeve QKUK 2015 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **QKUK** | Ditë shërimi | Nr.të operuarve | Vizita ambulantore | Shërbime laboratorike | shërbime tjera/apo te vecanta (diagnostike) | Total shërbimet QKUK |
| **2015** | 492853 | 21671 | 371101 | 1054397 | 851321 | 2791343 |
| **2014** | 479998 | 20496 | 377829 | 747141 | 689312 | 2314776 |
| **Ndryshimi** | 12855 | 1175 | -6728 | 307256 | 162009 | 476567 |
| **Ndyshimi ne %** | 2.67% | 5.73% | -1.78% | 41.12% | 23.50% | 20.58% |

*Tabela 7 : Totali Shërbimet e QKUK-se*

